



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 22.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

- I. **Z.Ganimet Sabedini**, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Gjilan, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z.Valdrin Bajrami.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Ganimet Sabedini dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 20.11.2024, Nr.07/7-2001/2024, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal z.Valdrin Bajrami, i cila ka dhënë dorëheqje për arsye familjare.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është z.Ganimet Sabedini.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 22.11.2024

Kreshnik RADONIQI
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Priština
Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 23 të Rregullores së Brendshme Nr. 02/2024, Për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 22.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Grupit të Katërt të Pozitave sipas Departamenteve, për Angazhimin e Stafit jo Permanent

- I. Miratohen grupi i katërt i pozitave sipas departamenteve, për angazhimin e stafit jo permanent, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Lista me pozita si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 22.11.2024



Nr	Angazhimi i personelit të përkohshëm për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 - Grupi i katërt	Nr. i personelit
1.	Zyrtar për Komunikim dhe Shërbim Votues	5
2.	Zyrtar të Trajnimit në SKQZ (dy faza, 5+4)	9
3.	Zyrtar të Trajnimit në KKZ	151
4.	Zyrtar për Klasifikim dhe Sistemim të Dokumenteve	2
5.	Zyrtar për Mbështetje Teknike	1
6.	Zyrtar i Personelit	1
Gjithsejtë		169

Br	Angažovanje privremenog osoblja za izbore za Skupštinu Kosova 2025 – Četvrta grupa	Br. osoblja
1.	Službenik za komunikaciju i usluge birača	5
2.	Službenik za obuku u SCIK (dve faze, 5+4)	9
3.	Službenik za obuku u OIK	151
4.	Službenik za klasifikaciju i sistematizaciju dokumenata	2
5.	Službenik za tehničku podršku	1
6.	Kadrovski službenik	1
	Ukupno	169



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 22.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Specifikave për Forma Zgjedhore

- I. Miratohen Specifikat për Forma zgjedhore.
- II. Specifikat si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 22.11.2024

Kreshnik RADONIQI
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Priština
Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64, nenin 70 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6, paragrafi 1.4 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024, Emërimi, Përbërja dhe Funksonimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 22.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Zëvendësimin dhe Emërimin e Anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Zubin Potokut

- I. Znj.Stanislava Vicentijević, emërohet anëtar i KKZ-së në komunën e Zubin Potokut nga subjekti politik GISPO, duke e zëvendësuar Znj.Gordana Vucinić, nga i njëjti subjekt politik, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtarit të emëruar të KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me vendimin e KQZ-së KQZ Nr.01/1845-2024, të datës 24.10.2024, Znj. Gordana Vucinić, nga subjekti politik GISPO, është emëruar anëtare e KKZ-së, ndërsa me kërkesën e subjektit politik në fjalë, të datës 18.11.2024, ka kërkuar zëvendësimin për arsyeje të dorëheqjes nga pozita e anëtares së KKZ-së, për arsyeje personale. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 22.11.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, si dhe nenin 103.4 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 22.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit për Shkatërrimin/ Asgjësimin e Materialit Zgjedhor

- I. Miratohet rekomandimi për shkatërrimin/asgjësimin e materialit zgjedhor, për të cilat kanë pushuar hetimet si rezultat i përkrahimit absolut për zgjedhjet e vitit 2012, zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014, si dhe materialeve zgjedhore për të cilat KQZ ka pranuar nga prokurorit aktvendime për Hedhjen Poshtë të Kallëzimeve Penale dhe Raporte për mbylljen e rasteve, sipas llojit të zgjedhjeve, viteve dhe vendotimeve.
- II. Rekomandimi dhe Lista si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 22.11.2024

